

20040621173

L I G J I PËR VEPRIMTARI TURISTIKE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra për kryerjen e veprimtarisë turistike.

Neni 2

Nocione të veçanta që përdoren në këtë ligj kanë kuptimin si vijon:

1. “Veprimtari turistike” është organizimi dhe realizimi i udhëtimeve turistike në vende turistike, verimeve familjare dhe ekskurzioneve tjera jokomerciale dhe aranzhmaneve të tjera turistike në vend dhe jashtë, ofrimi i informatave turistike, shitja dhe ndërmjetësimi gjatë shitjes së shërbimeve hoteliere ose të tjera turistike, ndërmjetësimi edhe gjatë dhënies së shtëpive, banesave dhe dhomave për turistë, kryerja e shërbimeve me ciceronë turistikë dhe shërbimeve të tjera.

2. “Shërbime të tjera” janë shitja e biletave të udhëtimit dhe sigurimi i udhëtarëve dhe turistëve, aktivitetet propagandistike turistike, organizimi i manifestimeve kulturore dhe sportive, punët e këmbimit, dhënia me qira e automjeteve dhe objekteve lundruese, shitja e suvenirëve, literaturës turistike dhe mallit tjetër që shitet në qarkullimin turistik, si dhe shitja e biletave për manifestime kulturore, sportive dhe të tjera, pagesa për llotto, prognozë sportive, llotari dhe ngjashëm;

3. “Kryerës të veprimtarisë turistike” janë shoqëritë tregtare, tregtarët individë dhe personat fizikë;

4. “Vend turistik” paraqet rajoni ose destinimi i cili si tërësi turistike organizative dhe funksionale disponon me kuriozitate natyrore, kulturore, historike dhe të tjera me rëndësi për turizmin, infrastrukturë komunale, të komunikacionit dhe turistike, si dhe objekte dhe lokale të tjera për vendosjen dhe qëndrimin e turistëve.

5. “Pako e aranzhmanit turistik” është kombinimi i arritur paraprakisht i së paku dy nga shërbimet që vijojnë, të shitura ose të dhëna në shitje, me kusht që shërbimi i përgjithshëm të zgjasë më shumë se 24:00 orë, ose përfshin vendosjen me bujtje, përkatësisht vendosjen dhe atë:

(a) transportin;

(b) vendosjen;

(c) shërbime të tjera turistike që nuk janë përfshirë me transportin dhe vendosjen dhe janë me rëndësi në kuadër të pakos së aranzhmanit turistik.

6. “Program i piknikeve” është kombinim i së paku dy shërbimeve të ofruara veç e veç, i cili zgjat më pak se 24 orë dhe nuk përfshin bujtjen përkatësisht vendosjen.

7. “Shfrytëzues” - konsumues është personi i cili blen ose pajtohet të blejë pakon turistike të aranzhmanit (kontraktuesi i primar), ose personi tjetër i cili në emër të kontraktuesit primar pajtohet të blejë pakon turistike të aranzhmanit (shfrytëzuesi tjetër – konsumues) ose cilido person tjetër, të cilit kontraktuesi primar ose shfrytëzuesi e tjerë ia kanë bartur shfrytëzimin e pakos turistike të aranzhmanit.

8. “Organizues i udhëtimit” është kryerësi i veprimtarisë turistike, i cili organizon pakon e aranzhmanit turistik dhe i cili e shet drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësit.

9. “Ndërmjetës” është personi juridik i cili shet ose ofron për blerje pakon e aranzhmanit turistik, që është përgatitur nga organizuesi i udhëtimit.

10. “Marrëveshje” është marrëveshja që i lidh shfrytëzuesin dhe organizuesin dhe /ose ndërmjetësin, e lidhur me shkrim sipas këtij ligji dhe Ligjit për raportet obligative.

11. “Veprimtari tuoperatorike” është tregtia me shërbime turistike me shumicë nga agjencitë turistike drejtpërdrejt ose me ndërmjetësimin e agjencive të tjera turistike.

12. “Shërbime në turizmin fshatar dhe etno turizëm” janë qëndrimi i turistëve në amvisëritë e fshatit për pushim dhe rekreim.

II. KRYERËSIT E VEPRIMTARISË TURISTIKE

Neni 3

Veprimtari turistike mund të kryejnë shoqëritë tregtare dhe tregtarët individë të regjistruar në regjistrin tregtar (kryerësit e veprimtarisë turistike), në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

Personat fizikë të cilët sipas dispozitave të këtij ligji kryejnë veprimtari turistike me pakicë, regjistrohen në regjistrin që e mban prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit në regjistrin që e mban prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e turizmit, i përcakton veprimtaritë me pakicë në sferën e turizmit.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetente për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 4

Themelues të agjencive turistike dhe byrove turistike mund të jenë persona juridikë të vendit dhe të jashtëm.

Neni 5

Shoqëri tregtare dhe tregtar individ, varësisht nga lloji i shërbimit që e ofron, mund të jetë agjencia turistike dhe byroja turistike.

Tregtar individ i cili veprimtarinë turistike të ciceronit turistik ose shoqëruesit turistik e kryen si profesion, përherë e mban emrin ciceron turistik ose shoqërues turistik.

Personi fizik i cili si profesion të lirë herëpashere kryen veprimtari turistike të ciceronit turistik ose shoqëruesit turistik e mban emrin ciceron turistik ose shoqërues turistik.

Neni 6

Shoqatat turistike të shoqatave sportive dhe sindikale, shoqëritë dhe shoqatat kulturore artistike, institucionet sociale shëndetësore dhe organizatat fetare dhe humanitare, mund të organizojnë udhëtime turistike për anëtarët e tyre dhe anëtarët e familjes së tyre më të ngushtë vetëm përmes agjencive turistike.

Personat nga paragrafi 1 i këtij neni, publikisht nuk mund të shpallin dhe reklamojnë udhëtime turistike nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç njoftimit të anëtarëve të këtyre organizatave dhe institucioneve.

Neni 7

Veprimtaria turistike kryhet sipas dispozitave të këtij ligji, rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, zakoneve të mira afariste dhe zakoneve të veçanta që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë turistike.

III. KUSHTET DHE MËNYRA PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË TURISTIKE

1. Kushtet minimale-teknike dhe kushtet e tjera për kryerjen e veprimtarisë

Neni 8

Për kryerjen e veprimtarisë turistike, objektet duhet t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara minimale-teknike dhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit, i përcakton kushtet minimale-teknike nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 9

Kryerësi i veprimtarisë turistike është i obliguar që plotësimin e kushteve nga neni 8 paragrafi 1 i këtij ligji t'ia paraqesë Inspektoratit shtetëror të tregut dhe te prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefektit të komunës të rajonit të Qytetit të Shkupit, sipas vendit dhe selisë së objektit, përkatësisht sipas vendit ku ofrohen shërbimet turistike, së paku tetë ditë para fillimit të kryerjes së veprimtarisë. Paraqitja bëhet me formular të posaçëm.

Prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit e informon prefektin e Qytetit të Shkupit për regjistrimin e kryer të personave fizikë në regjistër, sipas nenit 3 paragrafi 2 të këtij ligji, si dhe paraqitjen nga kryerësit e veprimtarisë turistike.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të fletëparaqitjes nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 10

Kryerësit e veprimtarisë turistike, veprimtarinë e kryejnë në objekt afarist.

Hapësira e objektit afarist nuk guxon të shfrytëzohet për dedikim tjetër (banim dhe prodhimtari), përveç ofrimit të shërbimeve të tjera të shënuara në nenin 2 paragrafin 2 të këtij ligji.

Lokali afarist nuk duhet të jetë doemos tërësi e veçantë afariste, nëse ai lokal gjendet në objekte dedikuar për aktivitete tregtare dhe bankare, në hotele, në lokale të panairëve, në terminale të komunikacionit rrugor, ajror dhe nautik.

Neni 11

Agjencitë turistike mund të kenë objekt afarist jashtë selisë së agjencisë turistike (në tekstin e mëtejme: ekspoziturë), e cila i plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 8 paragrafi 1 i këtij neni.

Ekspozitura nga paragrafi 1 i këtij neni, i kryen punët sipas licencës që e posedon agjencia turistike.

Kopje të licencës së marrë të agjencisë turistike, të verifikuar te noteri, doemos duhet të ketë edhe në lokalin e ekspoziturës.

2. Llojet e shërbimeve turistike

Neni 12

Agjencitë turistike i kryejnë shërbimet si vijon:

- 1) organizimin, shitjen dhe realizimin e pakove të aranzhmaneve turistike;
- 2) shitjen dhe ndërmjetësimin në shitje të shërbimeve hoteliere dhe turistike të tjera;
- 3) ndërmjetësimin dhe ofrimin e shërbimeve të udhëtimeve dhe qëndrimit dhe shërbimeve të tjera lidhur me to;

- 4) organizimin e shitjes së biletave dhe realizimin e programeve të pikniqeve;
- 5) pranimin dhe transportin e udhëtarëve;
- 6) shitjen dhe ndërmjetësimin në shitje të biletave ose rezervimin e vendeve për të gjitha llojet e mjeteve transportuese;
- 7) rezervimin e vendosjes dhe kushteve të tjera në objektet hoteliere;
- 8) përfaqësimin e agjencive turistike të vendit dhe të huaja;
- 9) dhënien e informatave turistike dhe materialeve promovuese turistike për aranzhmanet e veta, ngjarjet turistike dhe të tjera;
- 10) ndërmjetësimin në marrjen e vizave të nevojshme për aranzhmanet jashtë, si dhe lejet e nevojshme për gjueti, peshkatari, zhytje dhe leje të tjera të nevojshme për organizimin dhe realizimin e llojeve të ndryshme të turizmit;
- 11) organizimin dhe ndërmjetësimin në shitjen e shërbimeve të turizmit të stacionuar, fshatar, të banjave, shëndetësor, kongreseve, sportiv, të gjuetisë dhe llojeve të tjera të turizmit;
- 12) organizimin e shërbimit të shoqëruesve turistikë, si dhe pranimin e mysafirëve gjatë ardhjes dhe shkuarjes nga vendi në destinacionin turistik, si dhe shoqërimin e personave të mitur në kuadër të aranzhmaneve turistike;
- 13) organizimin e ofrimit të shërbimeve nga ciceronët turistikë, dhe
- 14) sigurimin e udhëtarëve dhe sendeve në rast të riatdhesimit, fatkeqësisë dhe sëmundjes.

Neni 13

Agjencia turistike mund të kryejë aktivitete turistike, komerciale, informative–këshilldhënëse dhe promovuese, si vijon;

- 1) promovimin e ofruesve të shërbimeve;
- 2) promovimin e partnerëve afaristë;
- 3) promovimin e aranzhmaneve turistike;
- 4) botimin e publikimeve turistike;
- 5) shfrytëzimin e mjeteve informative dhe promotive;
- 6) ofrimin e informatave dhe këshillave për udhëtim për mjetet e mundshme transportuese, orarin e udhëtimit, çmimet, rregullat, formalitetet dhe shërbimeve shoqëruese;
- 7) ofrimin e informatave për qëndrimin;
- 8) ofrimin e informatave për karakteristikat e destinimeve turistike, për kushtet e vendosjes dhe ushqimit, për sistemin shoqëroro-politik, për situatën politike, për çmimet e shërbimeve, për atraktivitetet natyrore dhe antropogjene, për jetën sportive, kulturore dhe zbavitëse, për gjuhët të cilat fliten dhe për situatën meteorologjike, dhe
- 9) dhënien e informatave të tjera: rreth sigurimit të polisave, dokumenteve të udhëtimit, raporteve bankare dhe valutore, kushteve të pagesës dhe shërbimeve shëndetësore.

Neni 14

Agjencia turistike, përveç kushteve nga nenet 12 dhe 13 të këtij ligji, mund të ofrojë edhe shërbime të tjera, në kushte të përcaktuara me ligj, si vijon: organizimin dhe ofrimin e shërbimeve lidhur me çeqe kartela dhe çeqe të udhëtimit, si dhe ofrimin e shërbimeve të këmbimit; huazimin dhe ndërmjetësimin në huazimin e automjeteve (rent-a-car, objekteve lundruese, fluturakeve, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve lundruese), organizimin e manifestimeve kulturore dhe sportive; shitjen e сувениrëve, literaturës turistike, gazetave, punimeve shtëpiake dhe mallit tjetër që zakonisht shitet në qarkullimin turistik; shitjen e biletave për shfaqje kulturore, sportive dhe të tjera; fletëllotarive dhe pagesën e llotos dhe parashikimit sportiv.

3. Të drejtat dhe obligimet e agjencive

Neni 15

Agjencia turistike varësisht nga licenca, i ka edhe të drejtat dhe obligimet si vijon:

- 1) në hyrje të lokalit afarist ta vendosë firmën;
- 2) shenjën “agjencia turistike”, agjencia e udhëtimit dhe shprehjet e zakonshme siç janë “Tours” dhe “Travel”, në firmë mund t’i shfrytëzojnë vetëm agjencitë turistike që kanë marrë licencë;
- 3) të ketë kodin e identifikimit;
- 4) të japë informatë me kërkesën e shfrytëzuesit të shërbimeve, me çfarë cilësie vepron dhe sa janë autorizimet e saj nëse përfaqëson agjenci tjetër turistike;
- 5) të lidhë marrëveshje me shfrytëzuesin e shërbimit në të cilin do të përcaktohen qartë kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve;
- 6) në materialet e shtypura promovuese si dhe në të gjitha dokumentet e punës, të shënohet qartë firma, selia dhe kodi identifikues i agjencisë turistike;
- 7) të lidhë marrëveshje vetëm me ndërmarrje të komunikacionit, mjetet transportuese të cilave i plotësojnë kushtet e përcaktuara me rregulla nga lëmi i komunikacionit rrugor publik;
- 8) të lidhë marrëveshje dhe të ndërmarrë aktivitete të tjera afariste vetëm me subjekte juridike hotelierike, të cilët posedojnë licencën dhe kategorinë e objektit;
- 9) të ruajë si fshehtësi afariste gjithçka që di për shfrytëzuesin e shërbimeve dhe sjelljen e tij edhe pa lejen e tij, përveç në kushte të përcaktuara me ligj askujt nuk guxon t’ia japë adresën e shfrytëzuesit të shërbimit, vendin dhe kohën e udhëtimit, qëndrimin, çmimin e paguar si dhe emrin e bashkudhëtarit të tij;
- 10) t’u përmbahet kushteve të përcaktuara në marrëveshjet që i bën me shfrytëzuesit e shërbimeve dhe personin e tretë si ofrues i shërbimeve;
- 11) ta informojë shfrytëzuesin për opcionet e tjera për dhënien e polisave të sigurimit që të përcaktohet çmimi i dorëheqjes nga ana e shfrytëzuesit ose çmimi i ndihmës në rast të riatdhesimit, fatkeqësisë dhe sëmundjes;
- 12) në vend të dukshëm në agjencionin turistik ta paraqesë licencën ose kopjen e vërtetuar te noteri;
- 13) t’i theksojë çmimet e aranzhmaneve turistike dhe shërbimeve individuale;
- 14) për çdo shërbim ose aranzhman të shitur të lëshojë fletëllogarinë nga arka fiskale si dhe faturën turistike për vendosje dhe shërbime të tjera të shfrytëzuesit të shërbimit, dhe
- 15) gjatë shitjes dhe realizimit të shërbimeve t’i përmbahet marrëveshjes dhe programit për aranzhmanin turistik.

Neni 16

Marrëveshja nga neni 15 paragrafi 1 pika 5 i përmban veçanërisht elementet si vijon:

- 1) destinacionin e udhëtimit ose destinacionet dhe kohën e qëndrimit me data;
- 2) mjetet, karakteristikat dhe kategoritë që do të shfrytëzohen, datat, koha dhe vendi i nisjes dhe i kthimit;
- 3) nëse pako-aranzhmani përmban vendosjen, lokacionin e vendosjes, kategorinë e tij turistike ose shkallën e konfortit, karakteristikat kryesore të tij dhe planin e shujtave;
- 4) a nevojitet numër minimal i njerëzve që pako-aranzhmani të realizohet dhe nëse nevojitet, afati i fundit për informimin e shfrytëzuesit nëse pako-aranzhmani anulohet;
- 5) vizitat, ekskurzionet ose shërbimet e tjera, të inkorporuara në çmimin e përgjithshëm të kontraktuar për pako-aranzhmanin;
- 6) emrin dhe adresën e organizuesit, ndërmjetësit të pako-aranzhmanit dhe aty ku duhet edhe të sigurohet;

7) çmimin e pako-aranzhmanit, indikacionet për mundësinë e revizionit të çmimeve, indikacioni për çfarëdo dogane, takse ose shpenzime për arkëtimin e shërbimeve të caktuara (fluturim, nisje për lundrim ose ankorim në port, ose shpenzime për nisje për lundrim nga porti dhe fluturim nga aeroporti, taksat turistike) nëse këto çmime nuk janë inkorporuar në pako-aranzhmanin;

8) planin dhe mënyrën e pagesës;

9) kërkesat e veçanta të cilat shfrytëzuesi ia ka paraqitur organizuesit ose ndërmjetsuesit kur ka rezervuar pako-aranzhmanin, të cilat i kanë pranuar;

10) kohën për të cilën shfrytëzuesi mund të ankohet për mosplotësimin ose plotësimin joadekuat të dispozitave të marrëveshjes.

Një ekzemplar i marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij neni i jepet shfrytëzuesit të shërbimit.

Neni 17

Fatura turistike jepet nga agjencia turistike që posedon licencë.

Fatura turistike mund t'i jepet shfrytëzuesit vetëm në emër dhe për llogari të agjencisë turistike që ka licencë.

Fatura turistike jepet së paku në tri ekzemplarë dhe i përmban elementet si vijon:

1) numrin dhe datën e lëshimit të faturës;

2) firmën e agjencisë turistike që e lëshon faturën;

3) numrin dhe llojin e licencës së agjencisë turistike;

4) emrin e shfrytëzuesit;

5) listën e shërbimeve të paguara që përfshihen në udhëtimin turistik;

6) datën për plotësimin e shërbimit të parë dhe të fundit;

7) numrin dhe datën e dokumentit me të cilin konfirmohet pagesa nga shfrytëzuesi;

8) nënshkrimin dhe vulën e dhënësit të faturës.

Neni 18

Agjencia turistike boton broshurë për udhëtimin dhe qëndrimin e shfrytëzuesve të shërbimeve. Informatat në broshurë duhet të jenë të sakta dhe të kuptueshme.

Broshura duhet t'i përmbajë elementet si vijon:

1) qëllimin dhe mënyrën e udhëtimit, si dhe karakteristikat e vendeve të udhëtimit;

2) mënyrën e vendosjes, lokacionin e tij, kategorinë ose shkallën e konfortit dhe karakteristikat e tij kryesore, lejen për vendosje dhe klasifikimin turistik sipas rregullave të vendit nikoqir;

3) planin e shujtave;

4) marshutën e rrugës;

5) informatat e përgjithshme për pasaportën dhe vizat dhe për formalitetet shëndetësore të nevojshme për udhëtimin dhe qëndrimin;

6) shumën e parave ose përqindjen e çmimit që duhet të paguhet në llogari dhe planin për pagesën e bilancit;

7) numrin minimal të njerëzve për fillimin e pako-aranzhmanit dhe afatin e fundit për informimin e shfrytëzuesit nëse tërhiqet nga pakoja.

Të dhënat që janë shënuar në broshurë janë obligative për organizuesin ose ndërmjetësin, nëse:

1) ndryshimet e të dhënave i janë paraqitur qartë shfrytëzuesit para nënshkrimit të marrëveshjes, dhe

2) ndryshimet janë bërë më vonë me marrëveshje ndërmjet palëve.

Neni 19

Kryerësit e veprimtarisë turistike, gjatë organizimit të veprimtarisë turistike në vendet e jashtme me autobus, obligohen të sigurojnë që mjeti transportues t'i plotësojë kushtet në pajtim me dispozitat nga sfera e komunikacionit publik rrugor dhe të ketë kondicioner dhe frigorifer për ftohje.

Neni 20

Agjencia turistike nuk guxon ta rrisë çmimin e përcaktuar në marrëveshje, 20 ditë përpara ditës së kontraktuar për fillimin e shfrytëzimit të shërbimeve turistike.

Neni 21

Në rast se agjencia turistike e anulon pako-aranzhmanin turistik për çfarëdo arsye, përveç me gabimin e shfrytëzuesit përpara datës së nisjes me marrëveshje, shfrytëzuesi i shërbimeve ka të drejtë:

1) të marrë aranzhman turistik i cili i përgjigjet ose pako-aranzhman tjetër të ngjashëm, me kualitet më të lartë, aty ku agjencia turistike mund t'i ofrojë si zëvendësim. Nëse pako-aranzhmani turistik i zëvendësuar është me kualitet më të ultë, agjencia turistike do t'ia kthejë dallimin e çmimit shfrytëzuesit; ose

2) do t'i kthehet në afatin e mundshëm më të shkurtër shumën e plotë që e ka paguar me marrëveshje, përveç nëse:

- pako-aranzhmani është anuluar për arsye se numri i personave që janë paraqitur është më i vogël se numri minimal i nevojshëm dhe shfrytëzuesi për këtë është njoftuar me shkrim, në periudhën e caktuar me marrëveshje për pako-aranzhmanin; ose

- anulimi, përveç në rast të stërngarkimit është nga faktori natyror, për shembull: rrethanave të pazakonshme dhe të paparashikueshme jashtë kontrollit të personit që thirret në to, ndërsa pasojave nga kjo nuk do të mund t'u iket bile edhe me marrjen e të gjitha masave të sigurisë.

Nëse pas nisjes, pjesa më e madhe e shërbimeve nuk janë realizuar/ofruar ose nëse agjencia turistike konstaton se nuk ka mundësi që pjesën më të madhe të shërbimeve t'i kryejë, do të propozojë aranzhmane alternative që përgjigjen për vazhdimin e pako-aranzhmanit, pa shpenzime plotësuese për shfrytëzuesin dhe nëse duhet do t'ia kompenzojë shfrytëzuesit dallimin ndërmjet shërbimeve të ofruara dhe të marra.

Nëse nuk ka mundësi të bëhen aranzhmane alternative, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, ose ato nuk pranohen nga shfrytëzuesi për shkaqe të arsyeshme, agjencia turistike do të bëjë aranzhmane alternative që përgjigjen pa shpenzime plotësuese të shfrytëzuesit, me transport ekuivalent prapa deri në vendin e nisjes, ose në ndonjë vend tjetër që pranon shfrytëzuesi, dhe nëse duhet do ta kompenzojë shfrytëzuesi.

Neni 22

Nëse shfrytëzuesi pengohet që të vazhdojë shfrytëzimin e pako-aranzhmanit turistik, ai mund t'ia transferojë rezervimin e tij, duke i dhënë paraprakisht organizatorit ose ndërmjetësuesit informatë me kohë në kohë të kuptueshme për qëllimin vet para nisjes, personit i cili i plotëson të gjitha kushtet i përkasin pako-aranzhmanit turistik. Bartësi i pako-aranzhmanit turistik dhe personi të cilit i është bartur pako-aranzhmani turistik, obligohen të jenë në lidhje të përhershme me organizuesin ose ndërmjetësin për pagesën e çfarëdo shpenzimeve plotësuese që do të ndodhin gjatë transferit të tillë.

Neni 23

Agjencia turistike gjatë realizimit të pako-aranzhmanit turistik ose udhëtimit e qëndrimit në vendet e jashtme, duhet të sigurojë informata për:

1) kohën, vendet e ndaljes dhe ndërlidhjeve transportuese, si dhe vendin e udhëtarit, për shembull: kabinën ose krevatin në anije, kabinën për fjetje në tren;

2) emrin, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit lokal të agjencisë turistike dhe ose ndërmjetësuesit, ose të agjencisë lokale të cilës shfrytëzuesi gjatë vështirësisë mund t'i paraqitet për ndihmë. Atje ku nuk ka agjenci të tillë, shfrytëzuesit doemos duhet t'i jepet numri i telefonit në rast urgjence, ose çfarëdo informate tjetër që do t'i mundësojë të kontaktojë me agjencinë turistike dhe /ose ndërmjetësuesin.

Agjencia turistike gjatë realizimit të pako-aranzhmanit turistik ose udhëtimit dhe qëndrimit në vendet e jashtme të personave të mitur, obligohet të mundësojë informata për vendosjen e kontaktit të drejtpërdrejtë me fëmijën dhe personin përgjegjës për shërbimin e fëmijës në vendin e udhëtimit dhe qëndrimit.

Neni 24

Agjencia turistike gjatë realizimit të pako-aranzhmanit turistik ose udhëtimit dhe qëndrimit në vendet e jashtme, obligohet që në dalje nga vendi të dëshmojë se posedon licencë (kopje të verifikuar te noteri), marrëveshje me objektet për vendosje në vendet e jashtme dhe dëshmi për pagesat e kryera për shërbimet e vendosjes dhe të tjera përmes institucionit përkatës bankar.

4. Kryerja e veprimtarisë turistike me licencë

Neni 25

Agjencitë turistike për kryerjen e veprimtarisë doemos duhet të kenë licencë për kryerjen e veprimtarisë turistike (në tekstin e mëtejme: licenca).

Licenca mund të jetë: licenca "A", licenca "B" dhe licenca "V".

Licencën nga paragrafi 2 i këtij neni e jep organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit, ose institucioni i autorizuar.

Që të autorizohet institucioni nga paragrafi 3 i këtij neni, duhet të ketë së paku tre persona të punësuar me arsimim sipëror edhe nga lëmi i drejtësisë, ekonomisë dhe turizmit. Institucionin nga paragrafi 3 i këtij neni e autorizon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimi e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës nga paragrafi 2 i këtij neni.

5. Procedura për marrjen e licencës

Neni 26

Agjencitë turistike për marrjen e licencës i paraqesin kërkesë dhënësit të licencës, duke e shënuar firmën dhe selinë e kërkuarit dhe llojin e licencës që kërkohet.

Kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni i bashkangjitet:

- 1) vendimi për regjistrim në regjistrin tregtar;
- 2) njoftimi për plotësimin e kushteve për kryerjen e veprimtarisë turistike;
- 3) të dhënat për personin përgjegjës;
- 4) dëshmi se ka lidhur marrëveshje vjetore për sigurim nga përgjegjësia për kryerjen e veprimtarisë nëse parashihet me këtë ligj;
- 5) dëshmi për bonitet pozitiv për gjashtë muajt e fundit përpara paraqitjes së kërkesës; dhe
- 6) deklaratë se nga dita e marrjes së licencës për çdo vit do të paraqesë dëshmi për bonitet pozitiv.

Kundër vendimit të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit, me të cilin refuzohet kërkesa për dhënien e licencës, mund t'i paraqitet ankesë Komisionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen e çështjeve juridike të shkallës së dytë nga sfera e turizmit.

Kundër vendimit të institucionit të autorizuar me të cilin refuzohet kërkesa për dhënien e licencës, mund t'i paraqitet ankesë ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit.

6. Lëshimi i licencës

Neni 27

Licenca lëshohet në afat prej 8 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga kryerësi i veprimtarisë turistike.

Licenca ka vlefshmëri tre vjet.

7. Regjistrimi i licencës në regjistër

Neni 28

Licenca regjistrohet në regjistrin e agjencive turistike që i mban dhënësi i licencës.

Institucioni i autorizuar nga neni 25 paragrafi 3 i këtij ligji, organit të administratës shtetërore kompetent për punët në lëmin e turizmit, i dorëzon njoftim për ndryshimet e bëra në regjistër nga paragrafi 1 të këtij neni, menjëherë pas lindjes së ndryshimit.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit.

8. Ndryshimi i elementeve nga përmbajtja e licencës

Neni 29

Çdo ndryshim të përmbajtjes së licencës, agjencia turistike obligohet t'ia paraqesë dhënësit të licencës në afat prej 8 ditësh nga dita e ndryshimit të bërë.

9. Pushimi i vlefshmërisë së licencës

Neni 30

Licenca pushon të vlejë:

- 1) pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së licencës;
- 2) nëse për çdo vit duke llogaritur nga dita e marrjes së licencës, nuk dorëzon dëshmi për bonitet pozitiv të licencës;
- 3) nëse agjencia turistike në periudhën e vlefshmërisë së licencës pushon t'i plotësojë kushtet për kryerjen e veprimtarisë turistike, përkatësisht kushtet e caktuara për marrjen e licencës përkatëse të parapara në nenet 31, 32 dhe 33 të këtij ligji, dhe
- 4) në bazë të kërkesës së bartësit të licencës për fshirje nga regjistri i agjencive turistike.

Vendimin për pushimin e vlefshmërisë së licencës sipas këtij neni, e merr ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit dhe institucioni i autorizuar nga neni 25 paragrafi 3 të këtij ligji.

Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni regjistrohet në regjistrin nga neni 28 i këtij ligji, përkatësisht në institucionin e autorizuar për dhënien e licencës.

Kundër vendimit për ndërprerjen e vlefshmërisë së licencës të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët në sferën e turizmit, mund t'i ushtrohet ankesë Komisionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen e çështjeve administrative të shkallës së dytë nga sfera e turizmit.

Kundër vendimit për ndërprerjen e vlefshmërisë së licencës të institucionit të autorizuar nga neni 25 paragrafi 3 të këtij ligji, mund t'i paraqitet ankesë ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit.

10. Kushtet për dhënien e licencës “A”, “B” dhe “V”

Neni 31

Për marrjen e licencës “A” agjencia turistike doemos duhet t’i plotësojë kushtet si vijon:

- 1) të lidhë marrëveshje vjetore me shoqërinë e sigurimeve për sigurimin për përgjegjësi nga kryerja e veprimtarisë në shumë prej 50.000 euro në kundërvlerë me denarë;
- 2) të ketë bonitet pozitiv për gjashtë muajt e fundit para paraqitjes së kërkesës, kurse për agjencitë e posathemeluara, pas kalimit të gjashtë muajve nga dita e marrjes së licencës;
- 3) të ketë së paku katër persona të punësuar, prej të cilëve dy persona me dëshmi se kanë njohuri aktive të një gjuhe botërore dhe njëri nga të punësuarit të ketë dhënë kursin IATA për shitjen e aviobiletave;
- 4) të ketë ciceron turistik dhe shoqërues turistik gjatë çdo realizimi të udhëtimit në vend dhe jashtë për së paku 15 persona.

Neni 32

Për marrjen e licencës “B” agjencia turistike doemos duhet t’i plotësojë kushtet si vijon:

- 1) të lidhë marrëveshje vjetore me shoqërinë e sigurimeve për sigurimin nga përgjegjësia për kryerjen e veprimtarisë, në shumë prej 15.000 euro në kundërvlerë me denarë;
- 2) të ketë bonitet pozitiv për gjashtë muajt e fundit, para paraqitjes së kërkesës, ndërsa për agjencitë e posathemeluara, pas kalimit të gjashtë muajve nga dita e marrjes së licencës;
- 3) të ketë së paku dy persona të punësuar, prej të cilëve një person me dëshmi se ka njohuri aktive të një gjuhe botërore, dhe njëri nga të punësuarit të ketë dhënë kursin IATA për shitjen e aviobiletave;
- 4) të ketë ciceron turistik dhe shoqërues turistik gjatë çdo realizimi të udhëtimit në vend dhe jashtë, për së paku 15 persona.

Neni 33

Për marrjen e licencës “B” agjencia turistike doemos duhet t’i plotësojë kushtet si vijon:

- 1) të ketë person të punësuar me kursin e dhënë IATA, për shitjen e aviobiletave;
- 2) të ketë ciceron turistik dhe shoqërues turistik, gjatë çdo realizimi të udhëtimit në vend dhe jashtë, për grupin prej së paku 15 persona.

11. Shërbimet e agjencive turistike

Neni 34

Poseduesi i licencës “A”, mund të bëjë organizimin e udhëtimeve turistike, në vend dhe jashtë (veprimtari turoperatorike).

Neni 35

Në bazë të licencës së marrë “A”, agjencia turistike mund të merret edhe me aktivitete ndërmjetësimi, organizative, informative-këshilldhënëse dhe promovuese dhe aktivitete të tjera lidhur me udhëtimin dhe qëndrimin e shfrytëzuesve të shërbimeve në vend dhe jashtë.

Neni 36

Për shitjen dhe realizimin e aranzhmanit turistik, agjencia turistike që ka marrë licencën “A”, lidh marrëveshje me shfrytëzuesin e shërbimeve turistike.

Marrëveshja nga paragrafi 1 i këtij neni, si bazë i përmban elementet e parapara me nenin 16 të këtij ligji dhe Programin për aranzhmanin turistik.

Programi i aranzhmanit turistik i përmban elementet si vijon:

- 1) destinimin e udhëtimit me kohën e qëndrimit sipas datave të caktuara;

- 2) llojin e transportit ose transportet dhe klasa me data, kohën dhe vendin e nisjes dhe arritjes;
- 3) vendosjen me lokacionin preciz dhe kategorinë e objektit për vendosje, nëse në vendin ku udhëtohet ka kategorizim, specifikat e veçanta dhe cilësitë kryesore të objektit dhe dhomat ku do të vendosen shfrytëzuesit e shërbimeve dhe t'u përmbahen ligjeve dhe rregullave të vendit-nikoqir;
- 4) kushtet për konsumimin e ushqimit dhe pijeve me caktimin e saktë të kategorisë së objekteve për këtë destinim, lokacionin e tyre dhe kohën e shfrytëzimit të shërbimeve në kuadër të aranzhmaneve turistike;
- 5) vizitat e lokacioneve atraktive turistike, me përshkrimin e lokalitetit, lokacionin e tij dhe kohën e vizitës;
- 6) shfrytëzimin e shërbimeve të veçanta gjatë kohës së qëndrimit me lokacionin dhe kohën e shfrytëzimit të shërbimeve;
- 7) itinerarin në të cilin përfshihen edhe marshutat;
- 8) çmimin e aranzhmanit turistik;
- 9) paralajmërimin e mundësinë së ndryshimit të çmimit dhe paralajmërimin për çfarëdo shpenzime, taksa ose kompensime që paguhen për shërbime të caktuara (taksa turistike, vendosje, ngarkim-shkarkim në porte dhe aeroporte) nëse këto shpenzime nuk përfshihen në aranzhman;
- 10) kushtet dhe mënyrën e pagesës;
- 11) sigurimin e shfrytëzuesve të shërbimeve dhe sendeve që i bartin dhe kompensimin e dëmit me fajin e agjencisë turistike;
- 12) numrin minimal të personave që përfshihen me aranzhmanin turistik, si shfrytëzues të shërbimeve;
- 13) afatin e fundit për njoftimin e shfrytëzuesve në rast të tërheqjes së realizimit të aranzhmanit;
- 14) sigurimin e aranzhmanit turistik me garancë në shoqërinë e sigurimeve, për kompensimin e shpenzimeve të shfrytëzuesit të shërbimeve në rastet si vijon: nëse shërbimet mungojnë, ndërsa agjencia turistike nuk ka fuqi pagese ose është në falimentim dhe nëse shfrytëzuesi i shërbimeve nuk mund të kthehet për arsyet e theksuara në këtë paragraf;
- 15) dhënia e vërtetimit për sigurimin e garancisë që i mundëson realizimin e drejtpërdrejtë të drejtave për kompensimi e dëmit për shpenzimet e shkaktuara.

Neni 37

Agjencia turistike, bartëse e licencës "B" mund të bëjë shitjen dhe ndërmjetësimin e udhëtimeve turistike, të organizuara nga kryerësit e veprimtarisë turistike me licencën "A", si dhe shërbime të tjera sipas nenit 12, 13 dhe 14 të këtij ligji.

Agjencia turistike që ka marrë licencën "B", mund t'i kryejë të gjitha aktivitetet në vendet e jashtme sipas këtij ligji, nëse autorizohet nga agjencia turistike që ka licencën "A", me lidhjen e marrëveshjes.

Në bazë të licencës së marrë "B", agjencia turistike mund të merret me të gjitha aktivitetet me të cilat merret agjencia turistike që ka marrë licencën "A", por vetëm në kuadër të vendit.

Neni 38

Agjencia turistike bartëse e licencës "B", mund të bëjë shitjen e udhëtimeve turistike në vend, të organizuara nga poseduesit e licencës "A" dhe licencës "B", të cilët obligohen që t'i sigurojnë udhëtarët.

Në bazë të licencës së marrë "B", agjencia turistike mund të merret me aktivitetet e shënuara në nenet 12, 13 dhe 14 të këtij ligji.

Agjencia turistike që ka marrë licencën "B", në vend mund ta përfaqësojë agjencinë turistike që posedon licencën "A" ose licencën "B", nëse ka marrë autorizimin e këtillë me lidhjen e marrëveshjes.

12. Ciceroni turistik

Neni 39

Ciceron turistik është personi i cili vizitorëve të vendit dhe të huaj në Republikën e Maqedonisë ua prezenton atraktivitetet natyrore dhe antropogjene, historinë e vendit dhe monumentet kulturore historike, veprat artistike, atraktivitetet etnografike dhe të tjera, ngjarjet historike, legjendat dhe figurat e këtyre ngjarjeve, rregullimin shoqëror të vendit dhe që ka aftësi komunikimi, njohuri të përgjithshme nga turizmi dhe psikologjia e turizmit dhe që e njeh gjuhën të cilën e flasin turistët e huaj.

Ciceron turistik nuk konsiderohet punëtori profesional, i cili kryen veprimtarinë e ciceronit në vendin e tij të punës te personat juridik në objektin afarist ku punon (muzeum, galeri, park nacional dhe ngjashëm), personi profesional i agjencisë turistike i cili përcjell grupin e turistëve nga vendi në vend, ciceroni në mal dhe shpellë, ciceroni në gjueti dhe peshkatari, si dhe udhëheqësi ose përcjellësi në ekskurzime dhe pikniqe.

Neni 40

Për ofrimin e shërbimit të ciceronit turistik, ciceroni turistik doemos duhet t'i plotësojë kushtet si vijon:

1. të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; dhe
2. të ketë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Ciceroni turistik doemos duhet të ketë së paku përgatitjen e mesme profesionale dhe provimin e dhënë profesional për ciceron turistik.

Neni 41

Provimi profesional për ciceron turistik jepet para komisionit të provimit.

Komisionin e provimit për dhënien e provimit profesional për ciceron turistik, e formon institucioni i arsimit sipëror për turizëm dhe hotelieri.

Provimi profesional për ciceron turistik jepet sipas programit të përcaktuar.

Programin për dhënien e provimit profesional për ciceron turistik e miraton institucioni i arsimit sipëror për turizëm dhe hotelieri, pas pëlqimit paraprak të organit të administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e arsimit dhe shkencës, organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor dhe organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës.

Programi nga paragrafi 4 i këtij neni shpallet në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Neni 42

Shpenzimet për dhënien e provimit profesional për ciceron turistik i paguan kandidati.

Shpenzimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i kompensojnë personat fizik dhe juridik të cilët janë të interesuar për shërbimet e ciceronëve turistikë.

Lartësinë e shpenzimeve nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit.

Neni 43

Kandidatit që e ka dhënë provimin profesional, institucioni i arsimit sipëror i lëshon çertifikatë.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të çertifikatës nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 44

Cilësia e ciceronit turistik dëshmohe me legjitimacion të veçantë.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Legjitimacionin nga paragrafi 1 i këtij neni e lëshon ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit ose institucioni i autorizuar për lëshimin e legjitimacioneve.

Që të autorizohet institucioni nga paragrafi 3 i këtij neni duhet të ketë të punësuar së paku tre persona me arsimim sipëror nga lëmi i drejtësisë, ekonomisë dhe turizmit. Institucionin nga paragrafi 3 i këtij neni e autorizon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit.

13. Shoqëruesi turistik

Neni 45

Shoqëruesi turistik është personi i cili e shoqëron grupin turistik. Ai duhet t'i njohë rajonet më të rëndësishme turistike në botë, si dhe vendet turistike në Republikën e Maqedonisë, rregullimin shoqëror, punët bankare dhe doganore, mundësitë e komunikacionit dhe të posedojë aftësi komunikimi dhe të flasë një nga gjuhët botërore.

Neni 46

Shoqëruesi turistik mund të ndihmojë në udhëtimin e grupit turistik gjatë kalimit të kufirit, pagesës dhe këmbimit të mjeteve financiare dhe gjatë dhënies së shërbimeve të tjera, ndërmjet shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë dhe ofruesve të shërbimeve.

Neni 47

Shoqëruesi turistik duhet të ketë së paku përgatitjen e mesme profesionale.

Neni 48

Cilësia e shoqëruesit turistik dëshmohe me legjitimacion të veçantë.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Legjitimacionin nga paragrafi 1 i këtij neni e jep ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit ose institucioni i autorizuar për lëshimin e legjitimacioneve.

Që të autorizohet institucioni nga paragrafi 3 i këtij neni, duhet të ketë të punësuar së paku tre persona me arsimim sipëror nga lëmi i drejtësisë, ekonomisë dhe turizmit. Institucionin nga paragrafi 3 i këtij neni e autorizon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit.

14. Byroja turistike

Neni 49

Byroja turistike i kryen punët si vijon:

- 1) ndërmjetëson në sigurimin e shërbimeve për vendosje shtëpiake;
- 2) shet bileta për manifestime kulturore, zbavitëse, sportive, rekreative dhe ekonomike;

- 3) shet suvenirë, panorama, broshura, harta turistike, filma, fotoaparatë;
- 4) jep informata turistike dhe kryen distribuimin e materialeve informative-promotive.

Neni 50

Themelues i byrosë turistike mund të jetë edhe prefekti i komunës, ndërsa për qytetin e Shkupit, prefekti i Qytetit të Shkupit.

15. Shërbimet në turizmin fshatar, etno dhe turizmin ekologjik

Neni 51

Shërbimet turistike në turizmin fshatar dhe etno turozëm janë: huazimi i kuajve për kalërim, foto safari, punimi dhe shitja e punëdoreve shtëpiake, suvenirëve, instrumenteve dhe prodhimeve të tjera dhe shërbimeve në amvisërinë fshatare.

Shërbimet turistike nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i ofrojë personi fizik i regjistruar te prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit te prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit.

Me shërbime të turizmit ekologjik, në kuptim të këtij ligji konsiderohen qëndrimi në rajonet me karakteristika të veçanta natyrore, si dhe në rajone të mbrojtura për pushim, rekreacion dhe shikimin e bukurive natyrore në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Me shërbime turistike nga paragrafi 3 i këtij neni konsiderohet huazimi i mjeteve transportuese për shikimin e bukurive natyrore, shitja e fryteve natyrore, shpjegimi i bukurive natyrore, foto safari dhe shërbime të tjera me të cilat nuk dëmtohet natyra në mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë.

Shërbimet turistike nga paragrafi 3 i këtij neni mund t'i ofrojë personi fizik i regjistruar te prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit te prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit.

Ofrimi i shërbimeve nga paragrafi 1 dhe paragrafi 3 i këtij neni bëhet me ndërmjetësimin e kryerësve të veprimtarisë turistike, përkatësisht hotelierike, në bazë të marrëveshjes.

16. Llojet tjera të shërbimeve turistike

Neni 52

Llojet tjera të shërbimeve turistike sipas këtij ligji janë: organizimi i aktiviteteve rekreative zbavitëse në plazhe dhe pishina, huazimi i mjeteve lundruese për dëfrim (lloje mjetesh lundruese, dërrasa për lundrim e ngjashëm), mjete për skijim në ujë, bicikletë, shtrat dhe ombrellë për mbrojtje nga dielli, mjete për peshkim, e ngjashëm.

Për ofrimin e shërbimit nga paragrafi 1 i këtij neni, ofruesi i shërbimit obligohet t'i sigurojë shfrytëzuesit shërbime për sigurim në rast lëndimi ose vdekjeje.

Shërbimin me pakicë nga paragrafi 1 i këtij neni mund ta ofrojnë personat fizikë.

Ofruesi i shërbimit nga paragrafi 1 i këtij neni, obligohet që pajisjen dhe mjetet që ia jep shfrytëzuesit, t'i mirëmbajë ashtu që të jenë të sigurta për shfrytëzim.

17. Orari i punës

Neni 53

Agjencitë turistike dhe byrotë turistike mund të punojnë çdo ditë pune, të diele dhe ditë feste.

Neni 54

Agjencitë turistike dhe byrotë turistike mund të punojnë 24 orë.

Kryerësi i veprimtarisë turistike pavarësisht e përcakton orarin e punës nga paragrafi 1 i këtij neni, në pajtim me interesat e tij afariste, karakteristikat rajonale dhe nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve dhe obligohet t'i përmbahet të njëjtit.

Neni 55

Agjencia turistike obligohet që orën e fillimit të orarit të punës dhe orarin e punës t'ia paraqesë prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, prefektit të komunës së rajonit të Qytetit të Shkupit dhe Inspektoratit shtetëror të punës, në afat prej tetë ditësh, para ditës së fillimit të kryerjes së veprimtarisë turistike dhe para ndryshimit të orës dhe orarit të punës së objektit.

Prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefekti i komunës së rajonit të Qytetit të Shkupit, mbajnë evidencë për orarin e punës së objekteve që punojnë në rajonin në kompetencë të tyre.

Në rast të shkaqeve objektive që kërkojnë mbylljen e objektit turistik ose ndryshimin e orarit të punës, për të cilat kryerësi i veprimtarisë turistike nuk mund të ndikojë, kryerësi i veprimtarisë turistike mund ta mbyllë objektin turistik, përkatësisht ta ndryshojë orarin e punës, pa e plotësuar obligimin nga paragrafi 1 i këtij neni, për çka obligohet ta njoftojë prefektin e komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefektin e komunës të rajonit të Qytetit të Shkupit dhe Inspektoratin shtetëror të punës, në afat prej 48 orësh nga dita e krijimit të rastit.

Kryerësi i veprimtarisë turistike e paraqet fletëparaqitjen nga paragrafi 1 i këtij neni, në formular për caktimin e orës së fillimit të orarit të punës dhe orarin e punës.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit për caktimin e orës për fillimin e kohës së punës dhe orarin e punës.

Neni 56

Kryerësi i veprimtarisë turistike obligohet që orarin e punës ta paraqesë në hyrje të objektit dhe në vend të dukshëm në objekt.

Kryerësi i veprimtarisë turistike obligohet t'i përmbahet orarit të punës.

Neni 57

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e turizmit, miraton Programin vjetor për propagandë të përgjithshme turistike dhe veprimtari informative në Republikën e Maqedonisë.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë.

IV. MBIKËQYRJA

Neni 58

Mbikëqyrje në zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e turizmit.

Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave me të cilat përcaktohen kompetencat e organeve të tjera të administratës shtetërore, e kryejnë ato organe në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

Mbikëqyrjen në punën e prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit ndaj mbajtjes së regjistrit për personat fizik të cilët herëpashere kryejnë veprimtari turistike të ciceronit turistik dhe shoqëruesit turistik, si dhe mbajtjes së regjistrit për dhënien e shërbimeve në etnoturizëm dhe turizmin fshatar dhe llojeve të tjera të shërbimeve hotelierike me pakicë, e kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit.

Neni 59

Punët e mbikëqyrjes inspektuese i kryen Inspektorati shtetëror i tregut përmes inspektorëve, në pajtim me dispozitat e Ligjit për inspeksionin e tregut dhe këtij ligji.

Neni 60

Punët e mbikëqyrjes inspektuese të kryerësve të veprimtarisë turistike me pakicë, të regjistruara në regjistrin që e mban prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit në regjistrin që e mban prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, i kryejnë inspektorët e autorizuar të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit inspektorët e autorizuar të Qytetit të Shkupit, siç janë:

1) plotësimi i kushteve dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë turistike të ciceronit turistik dhe shoqëruesit turistik;

2) kryerja e punëve nga byroja turistike; dhe

3) plotësimi i kushteve të turizmit fshatar dhe etno turizmit.

Neni 61

Inspektori i autorizuar komunal, ndërsa në qytetin e Shkupit inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nëse konfirmon se personi fizik:

1) veprimtarinë e udhërrëfyesit turistik ose shoqëruesit turistik e kryen pa u regjistruar në regjistrin që e mban prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit në regjistrin që e mban prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit (neni 3 paragrafi 2);

2) plotësimin e kushteve minimale teknike nuk e paraqet me formular të veçantë te prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit në regjistrin që e mban prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit (neni 9 paragrafi 1);

3) kryen veprimtari si ciceron turistik pa poseduar përgatitjen profesionale dhe provimin e dhënë profesional për ciceron turistik (neni 40 paragrafi 2);

4) kryen veprimtarinë si shoqërues turistik pa patur së paku përgatitjen e mesme profesionale (neni 47);

5) byroja turistike kryen aktivitete në kundërshtim me nenin 49 të këtij ligji;

6) kryen shërbime në turizmin fshatar, ekologjik dhe etno turizmin në kundërshtim me dispozitat nga neni 51 i këtij ligji;

7) nuk ia paraqet orarin e punës prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefektit të komunës së rajonit e Qytetit të Shkupit në kuptim të nenit 55 paragrafi 1 i këtij neni;

do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë dhe cakton afatin për mënjanimin e mangësive të konfirmuara.

Nëse në afatin e caktuar personi fizik nuk i mënjanon mangësitë e konfirmuara, inspektori i autorizuar i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, merr vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të këtij neni mund t'i ushtrohet ankesë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit.

Ankesa nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

Neni 62

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektori i autorizuar komunal, ndërsa në Qytetin e Shkupit inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit vie deri në njohuri se ka bazë për dyshim se është bërë kundërvajtje me të cilën është cënuar ky ligj ose dispozitë tjetër, obligohet pa shtyrje të paraqesë kërkesë për hapjen e procedurës kundërvajtëse.

Neni 63

Për inspektor të autorizuar komunal, ndërsa në qytetin e Shkupit inspektor të autorizuar të Qytetit të Shkupit, mund të emërohet personi që i plotëson kushtet si vijon:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) të ketë arsimim sipëror profesional nga profesioni ekonomik ose turistiko-hotelierik, dhe së paku dy vjet përvojë pune.

Neni 64

Mbikëqyrja e punës së Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, bazohet në parimin e ligjshmërisë, përgjegjësisë dhe pavarësisë në realizimin e kompetencave të tyre.

Gjatë mbikëqyrjes në punën e Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e turizmit i kryen punët si vijon:

1) përcjell ligjshmërinë e punës së Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit dhe ndërmerr masa e aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës, përkatësisht Qytetit të Shkupit, në pajtim me ligjin;

2) vlerëson se organet e Këshillit dhe prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, a sigurojë që kryerja e punës nga kompetenca e tyre të zbatohet në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara me ligj;

3) paralajmëron Këshillin dhe prefektin e komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, Këshillin dhe prefektin e komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshillin dhe prefektin e Qytetit të Shkupit për tejkalmimet e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe dispozitë tjetër dhe u propozon masa përkatëse për tejkalimin e situatës së këtillë;

4) paralajmëron për mangësi të caktuara materiale dhe procedurale në punën e Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, të cilat mund të pengojnë kryerjen e punëve me interes publik të rëndësisë lokale;

5) jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, që duhet t'i kryejnë në kuadër të ligjit, e me kërkesë të tyre;

6) përcjell miratimin me kohë të dispozitave të përcaktuara me këtë ligj të Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit;

7) i paraqet iniciativa dhe propozime Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, nëse konstaton që nuk është zbatuar ligji si rezultat i konfliktit të kompetencave ndërmjet organeve të komunës;

8) përcjell ligjshmërinë e vendimeve që i merr prefekti për zgjidhjen e punëve administrative, për të drejtat, obligimet dhe interesat e personave fizikë dhe juridikë të marra në bazë të këtij ligji dhe ndërmerr masa sipas autorizimit me ligj;

9) i njofton me kohë organet e Këshillit dhe prefektin e komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektin e komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektin e Qytetit të Shkupit për gjendjen e konstatuar në punën e tyre dhe për masat e ndëmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

Për masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga pikat 6 dhe 8 paragrafi 2 i këtij neni, organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit, e informon Këshillin dhe prefektin e komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit Këshillin dhe prefektin e komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshillin dhe prefektin e Qytetit të Shkupit.

Nëse edhe pas paralajmërimeve dhe masave të aktivitetëve të ndërmarra, Këshilli dhe prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, Këshilli dhe prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshilli dhe prefekti i Qytetit të Shkupit nuk sigurojnë kryerjen e punëve nga paragrafi 2 i këtij neni, sipas fuqisë së ligjit u merret ose kufizohet kryerja e kompetencës përkatëse.

Kryerjen e punëve që ndëmerren, e ndërmerr organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit, por më së shumti deri në një vit nga dita e marrjes së tyre.

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit, kryerjen e punëve të ndërmarra nga kompetencat e Këshillit dhe prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, i kryen në emër dhe për llogari të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

Neni 65

Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konfirmon se kryerësi i veprimtarisë turistike:

- 1) nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë turistike (neni 3 paragrafi 1);
- 2) e kryen veprimtarinë pa i plotësuar kushtet e përcaktuara minimale-teknike dhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj (neni 8);
- 3) për plotësimin e kushteve minimale-teknike nuk e paraqet me formular të veçantë në Inspektoratin shtetëror të tregut (neni 9 paragrafi 1);
- 4) lokali afarist shfrytëzohet në kundërshtim me dispozitat nga neni 10 paragrafi 2 i këtij neni.
- 5) shenjën “agjencia turistike”, agjencia e udhëtimit dhe shprehjet e zakonshme siç janë “Tours” dhe “Travel”, në firmë i shfrytëzojnë agjencitë turistike që nuk kanë marrë licencë (neni 15 paragrafi 1 pika 2);
- 6) nuk lidh marrëveshje me shfrytëzuesin e shërbimit, në të cilin do të përcaktohen qartë kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve (neni 15 pika 5);
- 7) nuk lidh marrëveshje me ndërmarrje komunikacioni, mjetet transportuese të së cilave i plotësojnë kushtet e përcaktuara me rregulla nga lëmi i komunikacionit rrugor publik (neni 15 pika 7);
- 8) lidh marrëveshje dhe ndërmerr aktivitete të tjera afariste me subjekte juridike hotelierike, të cilët nuk posedojnë licencën dhe kategorinë e objektit (neni 15 paragrafi 1 pika 8);
- 9) për çdo shërbim ose aranzhman të shitur nuk lëshon fletllogarinë nga arka fiskale si dhe faturën turistike për vendosje dhe shërbime të tjera shfrytëzuesit të shërbimit (neni 15 paragrafi 1 pika 14);
- 10) gjatë shitjes dhe realizimit nuk i përmbahet marrëveshjes dhe programit për aranzhmanin turistik (neni 15 paragrafi 1 pika 15);
- 11) gjatë organizimit të udhëtimeve turistike në vendet e jashtme me autobus nuk siguron që mjetet transportuese t'i plotësojë kushtet sipas dispozitave nga sfera e komunikacionit publik rrugor, nuk kanë kondicioner dhe frigorifer për ftohje (neni 19);
- 12) nuk ia kthen shumën e plotë që e ka paguar me marrëveshje, përveç në rastet e parapara në paragrafin 1 pika 2 nga neni 21 i këtij ligji.
- 13) nuk vepron sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 21 të këtij ligji;
- 14) gjatë realizimit të aranzhmanit turistik ose udhëtimit dhe qëndrimit në vendet e jashtme të personave të mitur nuk mundëson informata për kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijën dhe personin përgjegjës për shërbimin e fëmijës në vendin e udhëtimit dhe qëndrimit (neni 23 paragrafi 2);

15) gjatë realizimit të pako-aranzhmanit turistik ose udhëtimit ose qëndrimit në vendet e jashtme nuk ka dëshmi se posedon licencë (kopje të verifikuar te noteri), marrëveshje me objektet për vendosje në vendet e jashtme dhe dëshmi për pagesat e kryera për shërbimet e vendosjes dhe të tjera përmes institucionit përkatës bankar (neni 24);

16) nuk ka licencë për kryerjen e veprimtarisë turistike (neni 25 paragrafi 1);

17) një herë në vit nuk paraqet dëshmi për bonitet pozitiv (neni 30 paragrafi 1 pika 2);

18) poseduesi i licencës “A” gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i plotëson kushtet nga neni 31 i këtij ligji;

19) poseduesi i licencës “B” gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i plotëson kushtet nga neni 32 i këtij ligji; dhe

20) poseduesi i licencës “V” gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i plotëson kushtet nga neni 33 i këtij ligji;

do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej 30 ditësh, do ta mbyllë objektin turistik dhe në vend të dukshëm do ta paraqesë arsyen për mbylljen e objektit.

Nëse edhe për të dytën herë gjatë vitit bëhet kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, organi kompetent inspektues do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë turistike, në kohëzgjatje prej 60 ditësh, do ta mbyllë objektin turistik dhe në vend të dukshëm do të paraqesë arsyen për mbylljen e objektit.

Në rastet nga paragrafi 1 alinea 7 e këtij neni inspektori i tregut do t’i propozojë ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit ta marrë licencën.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni mund t’i ushtrohet ankesë ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit.

Ankesa e paraqitur kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk e shtyn zbatimin e tij.

Neni 66

Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konfirmon se kryerësi i veprimtarisë turistike:

1) në hyrje të lokalit afarist nuk e shënon firmën (neni 15 paragrafi 1 pika 1);

2) nuk ka kod të identifikimit (neni 15 paragrafi 1 pika 3);

3) në materialet e shtypura promovuese si dhe në të gjitha dokumentet e punës nuk shënohet qartë firma, selia dhe kodi identifikues i agjencisë turistike (neni 15 paragrafi 1 pika 6);

4) në vend të dukshëm në agjencinë turistike nuk e paraqet licencën ose kopjen e vërtetuar te noteri (neni 15 paragrafi 1 pika 12);

5) nuk i vendos çmimet e aranzhmaneve turistike dhe shërbimeve të veçanta (neni 15 paragrafi 1 pika 13);

6) marrëveshja nuk i përmban elementet e parapara me nenin 16 të këtij ligji;

7) fatura turistike nuk i përmban elementet e parapara me nenin 17 paragrafi 3 i këtij ligji;

8) informatat në broshurën e botuar nuk janë të sakta dhe të kuptueshme (neni 18 paragrafi 1);

9) broshura nuk i përmban elementet e parapara me nenin 18 paragrafi 2;

10) kryen aktivitete në kundërshtim me dispozitat nga neni 37 dhe 38 i këtij ligji.

11) angazhon ciceron turistik, punëtor profesional që e kryen veprimtarinë në vendin e tij të punës te personat juridikë në objektin afarist ku punon (muzeum, galeri, park nacional dhe ngjashëm), punëtorin profesional të agjencisë turistike e cila përcjell grupin e turistëve nga vendi në vend, ciceronin në mal dhe shpellë, ciceronin në gjueti dhe peshkatari, si dhe udhëheqësin ose përcjellësin në ekskursionet dhe pikniqe (neni 39 paragrafi 2);

12) angazhon shoqërues turistik i cili nuk ka së paku përgatitjen e mesme profesionale (neni 47);

13) nuk e paraqet orarin e punës në Inspektoratin shtetëror të punës (neni 55 paragrafi 1); dhe

14) nuk e vendos orarin e punës në hyrje të objektit dhe në vend të dukshëm në objekt dhe nuk i përmbahet orarit të punës që e ka paraqitur (neni 56 paragrafi 1);

do të marrë vendim me të cilin aty për aty e mbyll objektin turistik dhe i cakton afat prej pesë ditësh për mënjanimin e mangësive të konfirmuara. Nëse në afatin e caktuar nuk mënjahen mangësitë e konfirmuara, organi kompetent i inspeksionit merr vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë turistike, në kohëzgjatje prej 30 ditësh dhe në vend të dukshëm e paraqet arsyen për mbylljen e objektit.

Nëse edhe për të dytën herë gjatë vitit bëhet kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, organi kompetent inspektues do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej 60 ditësh, do ta mbyllë objektin turistik dhe në vend të dukshëm do ta paraqesë arsyen për mbylljen e objektit.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni mund t'i paraqitet ankesë ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e turizmit.

Ankesa e ushtruar kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e shtyn zbatimin e tij.

V. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 67

Me dënim me para prej 80 000 deri 250 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

- 1) kryen veprimtari pa u regjistruar në regjistrin tregtar (neni 3 paragrafi 1);
- 2) nuk organizon udhëtime turistike për anëtarët e vet dhe anëtarët e familjes së tyre të ngushtë përmes agjencive turistike, publikisht i shpall dhe reklamon udhëtimet turistike (neni 6 paragrafi 1);
- 3) nuk i plotëson kushtet e përcaktuara minimale-teknike (neni 8 paragrafi 1);
- 4) ekspozitura e agjencisë turistike kryen aktivitete në kundërshtim me licencën që e posedon agjencia turistike (neni 11 paragrafi 2);
- 5) nuk lidh marrëveshje me ndërmarrje komunikacioni, mjetet transportuese të së cilave nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me rregulla nga lëmi i komunikacionit rrugor publik (neni 15 pika 7);
- 6) lidh marrëveshje dhe ndërmerr aktivitete të tjera afariste me subjekte juridike hotelierike, të cilët nuk posedojnë licencën dhe kategorinë e objektit (neni 15 paragrafi 1 pika 8);
- 7) nuk e ruan si fshehtësi afariste gjithçka që di për shfrytëzuesin e shërbimeve dhe pa lejen e tij, përveç në kushte të përcaktuara me ligj e jep adresën e shfrytëzuesit të shërbimit, vendin dhe kohën e udhëtimit, qëndrimin, çmimin e paguar si dhe emrin e bashkudhëtarit të tij (neni 15 paragrafi 1 pika 9);
- 8) nuk u përmbahet kushteve të përcaktuara në marrëveshjet që i bën me shfrytëzuesit e shërbimeve dhe personin e tretë si ofrues i shërbimeve, (neni 15 paragrafi 1 pika 10);
- 9) për çdo shërbim ose aranzhman të shitur nuk i lëshon fletëllogarinë nga arka fiskale si dhe faturën turistike për vendosje dhe shërbime të tjera, shfrytëzuesit të shërbimit (neni 15 paragrafi 1 pika 14);
- 10) nuk i përmbahet Marrëveshjes dhe Programit për aranzhmanin turistik gjatë shitjes dhe realizimit (neni 15 paragrafi 1 pika 15);
- 11) gjatë organizimit të udhëtimeve turistike në vendet e jashtme me autobus nuk siguron që mjetet transportuese t'i plotësojë kushtet në pajtim me dispozitat nga sfera e komunikacionit publik rrugor, nuk kanë kondicioner dhe frigorifer për ftohje (neni 19);
- 12) bën rritjen e çmimit të përcaktuar me marrëveshje 20 ditë para ditës së caktuar për fillimin e shfrytëzimit të shërbimeve turistike (neni 20);
- 13) nuk ia kthen shumën e plotë që e ka paguar me marrëveshje, përveç në rastet e parapara në paragrafin 1 pika 2 nga neni 21 i këtij ligji;

14) nuk vepron në kuptim të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 21 të këtij ligji;

15) gjatë realizimit të aranzhmanit turistik ose udhëtimit ose qëndrimit në vendet e jashtme të personave të mitur nuk u mundëson informata për kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijën dhe personin përgjegjës për shërbimin e fëmijës në vendin e udhëtimit dhe qëndrimit (neni 23 paragrafi 2);

16) gjatë realizimit të aranzhmanit turistik ose udhëtimit ose qëndrimit në vendet e jashtme nuk ka dëshmi se posedon licencë (kopje të verifikuar te noteri), marrëveshje me objektet për vendosje në vendet e jashtme dhe dëshmi për pagesat e kryera për shërbimet e vendosjes dhe të tjera përmes institucionit përkatës bankar (neni 24);

17) nuk ka licencë për kryerjen e veprimtarisë turistike (neni 25 paragrafi 1); dhe

18) nuk e paraqet ndryshimin e përmbytjes së licencës (neni 29).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç dënimit në para, mund të shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej një deri në tri vjet.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës te personi juridik me dënim në para prej 10.000 deri 50.000 denarë.

Personi fizik që bën kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 1 e këtij neni do të dënohet me dënim në para prej 10.000 deri 20.000 denarë.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç dënimit në para, personit përgjegjës te personi juridik mund t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri në një vit.

Neni 68

Me dënim me para prej 50 000 deri 150 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

1) nuk e njofton me formular të veçantë Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe prefektin e komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit prefektin e komunës të rajonit të Qytetit të Shkupit, sipas vendit dhe selisë së objektit, përkatësisht sipas vendit ku jepen shërbimet turistike, së paku tetë ditë para fillimit të kryerjes së veprimtarisë (neni 9 paragrafi 1);

2) lokali afarist shfrytëzohet edhe për destinim tjetër (banim dhe prodhimtari) në kundërshtim me dispozitat nga neni 10 paragrafi 2 i këtij ligji;

3) shenjën “agjencia turistike”, agjencia e udhëtimit dhe shprehjet e zakonshme siç janë “Tours” dhe “Travel”, në firmë i shfrytëzojnë agjencitë turistike që nuk kanë marrë licencë (neni 15 paragrafi 1 pika 2);

4) nuk lidh marrëveshje me shfrytëzuesin e shërbimit, në të cilin do të përcaktohen qartë kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve (neni 15 paragrafi 1 pika 5);

5) marrëveshja nuk i përmban elementet e parapara me nenin 16 të këtij ligji;

6) fatura turistike nuk i përmban elementet e parapara me nenin 17 paragrafi 3;

7) poseduesi i licencës “A” gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i plotëson kushtet nga neni 31 i këtij ligji;

8) poseduesi i licencës “B” gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i plotëson kushtet nga neni 32 i këtij ligji;

9) poseduesi i licencës “V” gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i plotëson kushtet nga neni 33 i këtij ligji; dhe

10) kryen aktivitete në kundërshtim me dispozitat nga neni 37 dhe 38 të këtij ligji.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç dënimit në para, personit juridik mund t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej tre muaj deri në një vit.

Nëse personi juridik gjatë dy viteve nga dita e shqiptimit të masës nga paragrafi 2 i këtij neni bën veprime të njëjta për të cilat i është shqiptuar masa e sigurisë, do t'i shqiptohet masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë turistike prej dy deri në pesë vjet.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës te personi juridik me dënim në para prej 10.000 deri 20.000 denarë.

Përveç dënimit në para nga paragrafi 4 i këtij neni personit përgjegjës mund t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë përgjegjëse në sferën e turizmit, prej gjashtë muaj deri në një vit.

Neni 69

Me dënim me para prej 50 000 deri 120 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

- 1) në hyrje të lokalit afarist nuk e paraqet firmën (neni 15 paragrafi 1 pika 1);
- 2) nuk ka kod të identifikimit (neni 15 paragrafi 1 pika 3);
- 3) me kërkesën e shfrytëzuesit të shërbimeve nuk i jep informatë se në çfarë cilësie vepron dhe sa janë autorizimet e tij nëse përfaqëson agjenci tjetër turistike (neni 15 paragrafi 1 pika 4);
- 4) në materialet e shtypura promovuese si dhe në të gjitha dokumentet e punës, nuk shënohet qartë firma, selia dhe kodi identifikues i agjencisë turistike (neni 15 paragrafi 1 pika 6);
- 5) në vend të dukshëm në agjencinë turistik nuk e paraqet licencën (neni 15 paragrafi 1 pika 12), dhe
- 6) nuk e paraqet orarin e punës në hyrje të objektit dhe në vend të dukshëm në objekt dhe nuk i përmbahet orarit të punës që e ka paraqitur (neni 56).

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës te personi juridik, me dënim në para prej 10 000 deri 30 000 denarë.

Neni 70

Me dënim me para prej 20 000 deri 50 000 denarë, do të dënohet kryerësi i veprimtarisë turistike - tregatri individ për veprimet nga neni 66, 67 dhe 68 të këtij ligji.

Për veprimet nga neni 66 paragrafi 1 të këtij ligji, përveç dënimit me para, mund të shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë turistike të tregtarit-individ prej tre muaj deri në një vit.

Për veprimet nga neni 67 paragrafi 1 dhe neni 68 paragrafi 1 të këtij ligji, përveç dënimit me para mund të shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalesë për kryerjen e veprimtarisë turistike në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në një vit.

Neni 71

Me dënim me para prej 15 000 deri 50 000 denarë, do të dënohet personi fizik, nëse:

- 1) nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë turistike (neni 3 paragrafi 2 dhe neni 51 paragrafi 2);
- 2) kryen veprimtari të ciceronit turistik, personit që është punëtor profesional që e kryen veprimtarinë ciceron në vendin e tij të punës, te personat juridik në objektin afarist ku punon (muzeum, galeri, park nacional dhe ngjashëm), punëtorit profesional i agjencisë turistike e cila përcjell grupin e turistëve nga vendi në vend, ciceronit në mal dhe shpellë, ciceronit në gjueti dhe peshkatori, si dhe ciceronit ose përcjellësit në ekskurzione dhe pikniqe (neni 39 paragrafi 2);
- 3) kryen veprimtari si ciceron turistik ose shoqërues turistik, pa e dhënë provimin përkatës profesional (neni 40 paragrafi 2); dhe
- 4) jep shërbime pa ndërmjetësim të kryerësve të veprimtarisë turistike, përkatësisht hotelierike pa lidhur marrëveshje (neni 51 paragrafi 6).

Neni 72

Për veprimet nga neni 68 paragrafi 1, neni 69 paragrafi 1 i këtij ligji, inspektori i autorizuar komunal dhe inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, në vendin e ngjarjes mund të arkëtojë dënim në të holla, si vijon:

- 1) për personin juridik 10 000 denarë,
- 2) për personin përgjegjës 8 000 denarë,
- 3) për personin fizik - tregtarin individ 5 000 denarë.

Inspektori turistik-hotelierik i komunës dhe i Qytetit të Shkupit për veprimet nga neni 71 paragrafi 1 pika 1, 3 dhe 4 të këtij ligji, në vendin e ngjarjes mund të arkëtojë dënim në para, të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 73

Procedurat e filluara para ditës së zbatimit të këtij ligji do të kryhen sipas dispozitave të Ligjit për veprimtari turistike dhe hotelierike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/95, 33/2000, 25/2002 dhe 38/2003).

Neni 74

Kryerësit e veprimtarisë turistike, si dhe ata që kanë dhënë provimin e ciceronit turistik, obligohen ta harmonizojnë punën e tyre sipas dispozitave të këtij ligji në afat prej një viti nga dita e zbatimit të këtij ligji.

Neni 75

Rregullat e parapara sipas dispozitave të këtij ligji do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e zbatimit të këtij ligji.

Neni 76

Deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore të parapara me këtë ligj do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 77

Udhëheqjen e regjistrit dhe evidencës, të parapara me dispozitat e këtij ligji, i kryen punëtori që do ta marrë prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefekti i komunës së rajonit të Qytetit të Shkupit, në pajtim me nenin 80 të Ligjit për veprimtari hotelierike nga dita e zbatimit të këtij ligji.

Neni 78

Me ditën e zbatimit të këtij ligji pushojnë të vlejnë dispozitat për veprimtarinë turistike të Ligjit për veprimtari turistike dhe hotelierike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/95, 33/2000, 25/2002 dhe 38/2003).

Neni 79

Dispozitat e këtij ligji për transferin e kompetencave dhe dispozitat që kanë të bëjnë me transferin, do të aplikohen prej ditës së zbatimit të këtij ligji.

Neni 80

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të zbatohet nga dita e konstituimit të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektëve të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004).